



BULETIN MUJOR

QERSHOR 2024



PËRMBAJTJA

- Promovimi i Bashkëpunimit Rajonal në Sigurinë Kibernetike: Takimi në Kuadër të Kartës SHBA-Adriatike (A-5)
- AKSK Organizon Takimin Përmbyllës për Metodologjinë e Identifikimit të Infrastrukturave Kritike dhe të Rëndësishme të Informacionit
- AKSK në Bashkëpunim me SEI dhe Departamentin Amerikan të Shtetit zhvillon trajnimin për Menaxhimin e Riskut në Organizata
- Trajnimi i AKSK për rritjen e kapaciteteve të stafit të Infrastrukturave Kritike dhe të Rëndësishme të Informacionit me Bashkitë, Mikrofinancat, Turizmin dhe Median

Promovimi i Bashkëpunimit Rajonal në Sigurinë Kibernetike: Takimi në Kuadër të Kartës SHBA-Adriatike (A-5)



Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike, në bashkëpunim me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, zhvilloi në datën 21 Qershor në Tiranë takimin e përbashkët të drejtuesve politikë dhe teknikë në kuadër të kryesisë së Shqipërisë këtë vit në Kartën SHBA- Adriatike (A-5).

Takimi u mbajt me pjesëmarrjen e vendeve anëtare Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Bosnjës dhe Hercegovinës, Kroacisë, Malit të Zi, Maqedonisë së Veriut, atyre vëzhgues si Kosova, Serbia si dhe Sllovenia.

Qëllimi i këtij takimi ishte forcimi i bashkëpunimit rajonal në fushën e sigorisë kibernetike në këtë grupim, si dhe promovimi i diplomacisë kibernetike.

AKSK Organizon Takimin Përmbyllës për Metodologjinë e Identifikimit të Infrastrukturave Kritike dhe të Rëndësishme të Informacionit

Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK) organizoi në datën 12 Qershor takimin konsultues përmbyllës mbi draft metodologjinë për identifikimin dhe klasifikimin e operatorëve të infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit.

Ky proces intensiv gjithëpërfshirës i drejtuar nga AKSK, me mbështetjen e ekspertëve nga eGA, Estoni, shënon një hap të rëndësishëm për forcimin e bashkëpunimit me operatorët e infrastrukturave të informacionit të sektorit publik dhe atij privat. AKSK mbetet i angazhuar për të garantuar pjesëmarrje, transparencë, efikasitet dhe koherencë në proceset e vendimmarrjes për sigurinë kibernetike.



Adresa : Rruga "Papa Gjon Pali II", Nr. 3, Kati I Tiranë



www.aks.gov.al



[@aks.gov.al](https://www.instagram.com/aks.gov.al)



+355 422 21 039



AKSK në Bashkëpunim me SEI dhe Departamentin Amerikan të Shtetit zhvillon trajnimin për Menaxhimin e Riskut në Organizata



Rritja e kapaciteteve për vlerësim dhe menaxhim të riskut në sigurinë kibernetike është një nga objektivat e Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK).

Për këtë qëllim, më datat 3-5 Qershor, Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (AKSK) në bashkëpunim me Software Engineering Institute (SEI) dhe membështetje të Departamentit Amerikan të Shtetit, organizuan trajnimin onsite dhe online me temë “Enterprise Risk Management”.

Ky trajnim u zhvillua me pjesëmarrje të punonjësve të profilizuar në IT/ICT/siguri kibernetike dhe instruktorë nga Software Engineering Institute (SEI), Universiteti Carnegie Mellon.



Trajnimi i AKSK për rritjen e kapaciteteve të stafit të Infrastrukturave Kritike dhe të Rëndësishme të Informacionit me Bashkitë, Mikrofinancat, Turizmin dhe Median

AKSK, i angazhuar maksimalisht në rritjen e kapaciteteve të stafit të infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit si dhe institucioneve të pavarura në datat 18-19 Qershor organizoi për këtë qëllim trajnimin dy ditor me Bashkitë dhe Mikrofinancat, si dhe në datat 24-25 trajnimin me Turizmin dhe Median.

Fokusi kryesor ishte njohja dhe ndërgjegjësimi i personelit të IT/CT në fushën e sigurisë kibernetike, aftësimi i tij në përgjigjen ndaj incidenteve kibernetike si dhe përgatitja e tyre në identifikimin e kërcënimeve nëpërmjet Cyber Drill (CD) – Simulime reale të incidenteve të sigurisë kibernetike.

